

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E HËNË 11 PRILL 2022

Një fjalë kam unë, zonjë, për ty, drejtpërdrejt: respekto Rregulloren e këtij parlamenti dhe mos bëj siç bën në çdo seancë. Edhe sot e ke shkelur Rregulloren. Lista e drejtuar dhe e adresuar prej meje si kryetar i grupit ka një renditje dhe nuk të lejon ty të bësh kapërcime. Dakord? Në fakt, kjo do të duhej t'i adresohet Kryetares së Kuvendit, sepse është e disata seancë që ndodh po kjo gjë.

Ju, personalisht, sa herë hipni në atë karrige, bëni pikërisht këtë gjë, nuk respektoni atë që është lista e depozituar prej kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. E kam thënë disa herë, ia kam bërë me dije zonjës Nikolla, por kjo gjë ndodh gjithmonë, ka ndjesë nga zonja Nikolla, por sa herë që ajo ikën dhe vini ju, ndodh pikërisht kjo situatë. Merrni masa dhe respektojeni ju e para Rregulloren! Kaq kisha.